



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Elona Gjebrea Hoxha, Milva Ekonomi.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslim Murrizi, Ervin Salianni, Flamur Noka, Endrit Braimllari, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ismail Shehu – Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore

Behar Salillari – Përgjegjës i Stafit Teknik të Komisionit Qendror “Dëshmor i Atdheut”

Gjergj Velo – Kryetar i Organizatës “Dëshmoret e Atdheut”

Dalan Buxheli – Anëtar i Organizatës “Dëshmoret e Atdheut”

Shaqir Vukaj – Anëtar i Organizatës “Dëshmoret e Atdheut”

Shpresa Bejo – Anëtar i Organizatës “Dëshmoret e Atdheut”

Gentian Arapi – Anëtar i Organizatës “Dëshmoret e Atdheut”

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës së mbledhjes së komisionit kemi shqyrtimin e projektligjit “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Për të prezantuar këtë projektligj të ri kemi të ftuar zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes.

Faleminderit, zoti Koçi, dhe mirë se keni ardhur! Të ftuar kemi edhe zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, zotin Behar Salillari, përgjegjës i Stafit Teknik të Komisionit Qendror “Dëshmor i Atdheut”, zotin Gjergji Velo, kryetar i organizatës “Dëshmoret e Atdheut” dhe anëtarët e organizatës Dalan Buxheli dhe Shaqir Vukaj. Të shënuar kam si të ftuar edhe zonjën Shpresa Bejo dhe zotin Gentian Arapi.

Relatore e komisionit për këtë projekt jam unë.

Më lejoni që, përpara se t’i jap fjalën zotit Koçi për prezantimin e këtij projekti, t’i shpreh falënderimet në emrin tim personal, por besoj edhe të Komisionit të Sigurisë, Ministrisë së Mbrojtjes për këtë iniciativë të re ligjore që ka marrë. Pas të paktën 19 vjetësh që kemi pasur në fuqi ligjin për statusin e dëshmorit, kishte ardhur realisht koha, dhe më mirë vonë se kurrë, që të shikonim një projekt të ri, me qëllim që t’u njohim një status sa më të denjë të gjithë dëshmorëve të atdheut. Sidoqoftë, për të prezantuar projektin dhe për të diskutuar më tej bashkë edhe me të ftuarit, do t’ia jap fjalën në fillim zotit Koçi, më pas zotit Velo, sepse organizata “Dëshmorët e atdheut” ka përcjellë në Komisionin e Sigurisë disa amendime lidhur me këtë projekt, më pas vazhdojmë me procedurën, sikurse na i imponon Rregullorja.

Zoti Koçi, fjala është për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare,

Qeveria prezanton projektligjin “Për statusin e dëshmorit të atdheut” bazuar në faktin që nga viti 2000 deri më sot nuk ka funksionuar ligji nr. 8607, i cili ka rregulluar deri tani dhënien e statusit, kriteret dhe procedurat apo edhe të drejtat e përfitimit që rrjedhin nga shpallja ose dhënia e statusit “Dëshmor i atdheut”. Praktika e punës në zbatim të këtij ligji bëri të domosdoshme

rishikimin e tij dhe rezultoi se tashmë duhej një projektligj i ri për të rregulluar të gjitha ato që thashë më sipër. Qëllimi i projektligjit është shpallja dhe njohja e statusit “Dëshmor i atdheut” për persona të cilët me akte të rralla heroizmi dhe vetëmohimi kanë dhënë jetën në luftën për liri, për pavarësi, për çlirim kombëtar apo në mbrojtje të integritetit territorial të Shqipërisë ose që kanë dhënë jetën në rastet e luftës kundër terrorizmit, kundër krimit apo në mbrojtje të jetës së individit, të mbrojtjes së pronës private apo edhe publike, si dhe në rastin e ndihmës që jepet kur ka fatkeqësi natyrore në ndihmë të popullsisë.

Sigurisht që projektligji i ri ka disa tipare të reja krahasuar me ligjin e vjetër, i cili duhet thënë se gjatë funksionimit të tij ka detyruar komisionin e deritanishëm të statusit “Dëshmor i atdheut” të zhvillojë rreth 56 mbledhje. Ka shqyrtuar rreth 6623 propozime dhe dosje të dërguara nga prefektët apo nga këshillat e qarqeve me propozime e me dokumente shoqëruese. Deri tani ka shpallur në zbatim të këtij ligji 705 e persona të propozuar dëshmorë të atdheut, ndërsa pjesa tjetër është refuzuar, sepse nuk ka plotësuar kriteret e ligjit. Aktualisht familjet që përfitojnë nga statusi “Dëshmor i atdheut” janë rreth 380 familje dhe vlera e shpërblimit financiar është 7 mijë lekë, pra është një vlerë e rritur në krahasim me 5 mijë që ka qenë disa vjet më parë. Ky vendim është marrë nga qeveria jonë.

Disa nga risitë që sjell ky ligj janë këto: së pari, janë zgjeruar kriteret që duhet të plotësohen për shpalljen apo për njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, sidomos për sa i përket luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Me këtë rast dua të them se ligji i ri vë në vend edhe disa padrejtësi të kryera deri tani jo vetëm kur ka funksionuar Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut”, por edhe më parë. Ne kemi shumë raste kur shtetas të ndryshëm, të cilët kanë humbur jetën në të njëjtat rrethana, nuk kanë janë shpallur dëshmorë, ndërkohë të tjerët janë shpallur dëshmorë edhe për arsye politike.

Ligji i përjashton nga dhënia apo njohja e statusit “Dëshmor i atdheut” të gjithë ata që janë dënuar me vendime gjykatë të formës së prerë për krime kundër njerëzimit, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit apo për veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë, si dhe për vrasje me dashje pas datës 9 maj 1945. Gjithashtu, sipas ligjit është zgjeruar lista e dokumenteve që janë të vlefshme për të kërkuar shpalljen dhe pastaj njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”. Gjithashtu, ne kemi demokratizuar më tej rrethin e institucioneve që bëjnë propozime duke përcaktuar edhe këshillin e bashkisë si një institucion që mund të propozojë dhënien e statusit “Dëshmor i atdheut”. Ligji i njeh të drejtën edhe ministrit në raste të veçanta për

të propozuar dhe për të kërkuar dhënien e statusit “Dëshmor i atdheut”. Kjo bëhet kryesisht për rastet të cilat janë urgjente, siç ka qenë, për shembull, rasti i dy pilotëve, të cilët në vitin 2016 u aksidentuan me helikopter dhe humbën jetën. Janë rishikuar disa dispozita, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e nderimit të dëshmorëve të atdheut dhe të menaxhimit të varrezave të dëshmorëve. Ligji i vjetër nuk e ka pasur fare këtë gjë dhe ne jemi përpjekur që ta rregullojmë këtë çështje, duke ndarë dhe duke u dhënë një status të veçantë varrezave të dëshmorëve të kombit.

Në lidhje me familjen e dëshmorit të atdheut janë bërë disa ndryshime, të cilat mundësojnë zgjerimin e rrethit familjar për efekt nderimi dhe jo për efekt financiar në përputhje me Kodin e Familjes. Mendoj se këto janë disa nga risitë që përcakton ligji.

Dua të them se gjatë praktikës të punës së komisionit janë vënë re shumë mangësi, shumë detaje të vogla, të cilat e kanë penguar gjykimin objektiv të komisionit, sepse vetë ligji e pengonte një vendimmarrje sa më objektive. Kështu që mendoj se ligji i ri i rregullon të gjithë këto çështje dhe të gjitha procedurat, por sidomos kriteret. Gjithsesi, gjatë shqyrtimit nën për nën mendoj se ka vend për një dy redaktime, të cilat nuk e ndryshojnë thelbin e projektligjit të propozuar. Ndërkohë, dua të them që shqyrtimi i të gjitha propozimeve ka qenë serioz. Në grupin e punës kanë qenë edhe përfaqësues të organizatës kombëtare të dëshmorëve të luftës dhe të dëshmorëve të tjerë të atdheut. Ne kemi qenë vazhdimisht në kontakt me këtë organizatë, sidomos me autoritetet drejtuese të kësaj organizate për të bërë përmirësimet e nevojshme. Gjithashtu, është në praktikën e komisionit e të parlamentit që ky proces të vijojë edhe gjatë kësaj procedurë shqyrtimi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjala është për ju zoti Velo.

Gjergj Velo – Zonja Kryetare, ju falënderojmë ju dhe të gjithë anëtarët e komisionit për këtë seriozitet që tregoni ndaj organizatës më të shenjtë, siç e quajmë ne, “Dëshmorët e atdheut”. Vërejtjet konkrete, pas një pune të madhe që është bërë, do t’i thotë nënkryetari, zoti Shaqir Vukaj, një nga njerëzit më me vlerë që kemi në organizatën tonë, si edhe disa të tjerë.

Kam disa fjalë për komisionin. E thatë bukur, kryetare, që është më mirë vonë se kurrë, por jo shumë vonë... Para disa ditësh është botuar një reportazh për Haxhi Gjozen nga Menkulasi i Devollit, babi i të cilit është plagosur në luftë, i shtruar në spitalin e partizanëve u mor i gjallë nga bashkëpunëtorët e fashizmit, u lye me vajguri dhe u dogj. Motër e vëlla ishin të dy në luftë. Motra që jeton sot, ka një plumb në trup. Në moshë të madhe, mbi 70 e ca vjet, ka një shtëpi të

mbuluar më llamarinë dhe ka si ekonomi shtëpie atë copën e tokës që ka marrë sipas ligjit nr. 7501 dhe 1 dhi. U është drejtuar organeve të shtetit tonë për ndihmë ekonomike. Kështu ka ndodhur realisht. Ato i thonë se ke këtë, atë dhe nuk përfiton ndihmë ekonomike. Disa nga ata që kanë qenë bij bashkëpunëtorësh sot janë ndihmuar, madje me ekonomi më të mirë, më shtëpi më të mirë. Thotë: pse ata që më vranë, me pushkatuan dhe kam edhe plumbin e tyre në trup janë më mirë ekonomikisht se ne? Thotë: për ata ka ligj. Po për ne? Thotë: nuk ka ligj. Prandaj thashë që Haxhi Gjoza është përfaqësues i familjeve shqiptare. Duke dëgjuar këtë shembull, besoj se do t'ua tërheq sadopak vëmendjen anëtarëve të Komisionit të Sigurisë e të gjithë parlamentit për ta marrë shumë seriozisht këtë shtresë që jeton në emigracion, në varfëri. Ndërkohë, dua të them se nga përfaqësues të zgjedhur, deputetë, ministra, drejtorë, administratorë deri edhe përfaqësues të thjeshtë të organeve pushtetit nuk merren parasysh dhe janë për të qarë hallin. Prandaj ka ardhur koha për këtë ligj dhe vini dorën në zemër.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Velo!

Po, zoti Vukaj.

Shaqir Vukaj – Do të flas shkurt, sepse më gjatë do të flas gjatë diskutimit nen për nen. Problemi i dëshmorëve në Shqipëri është një problem shumë i koklavitur. Unë kam filluar të merrem vonë, këto katër vjetët e fundit, por nga puna intensive në arkivat tona të shtetit, të ushtrisë, të Ministrisë së Brendshme kam parë gjëra të pabesueshme. Thuhet nga studiues seriozë se në Shqipëri kemi rreth 50 mijë të varë që nga vitet 1870-1878. Gjatë Luftës së Dytë Botërore janë deklaruar zyrtarisht 28 mijë të vrarë. Në atë kohë OKB-ja ka dhënë shifrën 30 mijë. Gazeta e kuislingëve në tetor të vitit 1944 ka dhënë shifrën 28 mijë. Realisht, me shifra në një botim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes kemi rreth 12 mijë të shpallur dëshmorë të të gjitha kohëve. Pra, ne sot në Shqipëri kemi një situatë shumë të paqartë lidhur me dëshmorët e atdheut. Kjo ka ndodhur për arsye se asnjë qeveri, duke filluar që nga qeveria e parë e deri tek e fundit, nuk është marrë seriozisht me këtë problem. Ne nuk kemi një inventar, një libër të artë, siç e kanë vendet e tjera, të këtyre njerëzve që kanë dhënë jetën për këtë vend.

Prandaj mendojmë se ka ardhur koha që ky problem të merret shumë seriozisht nga shteti, nga qeveria. Në diskutimet nen për nen do të ngremë edhe një problem, i cili, për mendimin tonë, është tepër i rëndësishëm: të veprojmë siç veprojnë vendet e tjera demokratike. Shteti, qeveria të krijojë një institucion të posaçëm shtetëror, institut ose komitet, nuk ka rëndësi emërtimi i tij, që

të merret me këto probleme, sepse problemet e dëshmorëve i kemi të pabesueshme. Nuk do të hyj në hollësi, por janë në një gjendje të paqartë. Ne në organizatën tonë kemi 10130 dëshmorë të shpallur. Nga letrat që kam hapur unë në arkiva e Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe atë të shtetit kam gjetur qindra të shpallur dëshmorë dhe nuk figurojnë në asnjë listë. Kemi qindra të tjerë të shpallur në vitet '70-80 kur këtë kompetencë ua lanë komiteteve ekzekutive, por që nuk dihen se ku janë. Pra, kemi një situatë shumë të çorientuar në lidhje me dëshmorët e atdheut. Prandaj ne kemi propozuar dhe insistojmë që të vihet në ligj krijimi i një institucioni shtetëror. Kemi institucione që merren me të persekutuarit, por për dëshmorët, ata që kanë dhënë jetën, nuk kemi asgjë shtetërore. Ne jemi organizatë amatore, nuk merremi me këto probleme. Prandaj them që duhet një institucion shtetëror të merret me këtë.

Ne kemi edhe një problem tjetër, që në ligj nuk është parashikuar. Ne jemi Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut, ku fillimisht kjo organizatë ka qenë brenda Organizatës së Veteranëve, pastaj ka dalë më vete dhe sot funksionon si organizatë kombëtare, që ka degë në të gjitha rrethet, boton revista, libra e të tjerë. Për mendimin tonë duhet të vihet detyrimisht në ligj që kjo organizatë kombëtare duhet të jetë prezente në aktivitete, të njihet nga shteti dhe të ndihmohet me buxhet, ashtu siç ndihmohen edhe organizatat e tjera.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Shumë faleminderit për prezencën dhe për shpjegimet!

Dua të them edhe unë diçka për ligjin. Unë e thashë që në fillim që ky ishte ligji i duhur, projekt që ndoshta e prisnim prej shumë kohësh dhe që gjërat do të fillojnë të ndryshojnë në drejtim të njohjes së meritave të të gjithë atyre që janë vetëmohuar jo vetëm për pavarësi dhe çlirim të vendit, por që në vijim kanë bërë të njëjtën sakrificë, por për interesat më të larta të kombit. Më vjen mirë që Ministria e Mbrojtjes e ka marrë këtë iniciativë, duke e parë si pikë të parë pikërisht zgjerimin e rrethit të atyre që u takon statusi i dëshmorit.

Nga ana tjetër, e kam parë me shumë vëmendje këtë projekt për një arsye të thjeshtë, pasi shumica prej nesh në këtë komision, por edhe të gjithë deputetëve të tjerë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët kanë disa mandate si të tillë, kanë qenë prezentë në festat e çlirimit apo më 29 nëntor në takime me veteranët dhe me pasardhësit e tyre dhe pa dyshim që e kemi ndjerë nevojën e këtij ndryshimi në bisedat që kemi bërë me ta. Kështu që mendoj se ka ardhur momenti që fjalët tona, drejtuar atyre me respekt dhe me nderim, të mund të materializohen konkretisht në një ligj, i cili njeh një status dinjitoz për të gjithë dëshmorët e atdheut dhe që i lartëson dhe i evokon këto vlera,

sepse është e rëndësishme që këto vlera të mos humbasin edhe për brezat që vijnë. Pra, asgjë nuk duhet harruar nga ajo që ka ndodhur shumë kohë më parë. Kështu që ligji ose projekti, meqenëse ende nuk e kemi përfunduar përmbajtjen e tij, reflekton shumë nga këto momente, të cilat fillojnë me vlerësimin se kush do të njihen si dëshmorë të atdheut, ku natyrisht që nuk do të jenë vetëm ata që kanë luftuar dhe kanë dhënë jetën e tyre për pavarësinë dhe lirinë e këtij vendi, por edhe ata që për interesa të tjera kombëtare apo interesa të larta publike janë vetësakrifikuar.

Ligji vërtet nuk ka fuqi prapavepruese, por ka një moment shumë të rëndësishëm që përjashton nga dhënia e statusit “Dëshmorë të Atdheut” të gjithë ata që janë dënuar për vepra të rënda, si krimet kundër njerëzimit, për bashkëpunim me pushtuesit e vendit apo për veprimtari terroriste, siç e theksoi zoti Koçi në fjalën e tij.

Më vjen mirë që është zgjeruar rrethi i autoriteteve që mund të kërkojnë njohjen e statusit të dëshmorit. Besoj se kjo do të ndihmojë të gjithë të interesuarit që të kenë pika më të lehta aksesit dhe kontakti, në mënyrë që të marrin atë që u takon.

Po kështu një kapitull i rëndësishëm është ai që ka të bëjë me varrezat e dëshmorëve dhe ceremonitë në nderim të tyre. Në fakt, ky është një kapitull krejt i ri, ku unë kam parë që ju keni propozuar edhe disa ndërhyrje të tjera për ta plotësuar atë kapitull dhe mendoj se është vendi që ne ta diskutojmë me kolegët. Unë dua t’i orientoj të gjithë anëtarët e komisionit në ato pika që do të kenë diskutim. Konkretisht, Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të Atdheut ka kërkuar që si subjekt i këtij ligji të njihet edhe organizata në fjalë. Kjo për arsyen e vetme, ashtu sikur u shprehën, që janë organizatë kombëtare e strukturuar në degë në të gjithë Shqipërinë. Pjesë e kësaj organizate, edhe me njohjen që kemi nga terreni, janë pothuajse të gjithë pasardhësit e dëshmorëve, pra të interesuarit në vetë të parë, që kontributi dhe sakrifica e të afërmeve të tyre të mos humbasë, por të kujtohet dhe të nderohet ashtu siç e meritojnë. Po kështu është kërkuar një mundësi që për të gjithë ata që u është njohur statusi mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara të mund t’u hiqet. Edhe kjo besoj se është një pikë e rëndësishme që ne duhet ta diskutojmë, sepse gjatë këtyre viteve kanë ndodhur edhe çudi të këtij lloji, që bashkëpunëtorët me nazifashistët kanë dalë sikur kanë qenë pjesëmarrës në luftën antifashiste nacionalçlirimtare dhe në mënyrë të padrejtë i kanë përfituar këto statute. Ky është një tjetër moment ku ne mund të reflektojmë.

Një moment tjetër, që unë besoj se ia vlen ta diskutojmë, është mënyra sesi është konceptuar ndërveprimi ndërmjet komisionit qendror për njohjen e statusit dhe komisioneve që do të projektohen në çdo bashki të Shqipërisë. Është ndërtuar një strukturë e tillë që propozohet nga

ministra. Unë dua që kolegët ta kenë në vëmendje këtë gjë, ku momenti i parë i depozitimit të kërkesës për njohjen e statusit duhet të vijë në komisionet vendore dhe komisionet të kenë të drejtë ta njohin ose jo statusin. Unë nuk e di nëse kjo është struktura më e mirë për këtë gjë. Parimisht, unë si juriste dua të them që nivelin administrativ komisionet t'i ndërtonin me dy shkallë dhe komisionet vendore të shërbenin për marrjen e dokumenteve dhe për relativimin e çështjes te komisioni qendror, në mënyrë që t'u japin mundësi të interesuarve që para se të shkojnë në gjykatë, në rast se kanë ankime për vendimin që do të marrë komisioni qendror për njohjen e statusit të dëshmorit, të drejtohen më parë tek organi administrativ dhe, nëse nuk janë dakord me vendimin e këtij organi, të mund të shkojnë te Gjykata Administrative.

Në qoftë se i referohemi Kodit të Procedurave Administrative, parimi është që ankimet duhen ezauruar brenda organit administrativ, të shkohet deri tek organi më i lartë, pastaj të mund të shkosh në gjykatë nëse nuk je dakord me vendimmarrjen e tyre. Sidoqoftë ky është mendimi im personal, siç e kam parë unë projektin, por kjo nuk do të thotë se ky mund të bëhet fakt pa u diskutuar me të gjithë ju. Besoj se ky është një moment i rëndësishëm, pasi thelbi i ligjit është vendosja e kriterëve dhe përshkrimi i procedurave nëpërmjet së cilës duhet të ecin të gjithë të interesuarit për të njohur statusin e dëshmorit. Kështu që është e rëndësishme që në këto procedura t'i bëjmë të kuptueshme, të qarta, por edhe të tilla që të sigurojnë akses në të drejtën e ankimit, në mënyrë që e drejta e ankimit të mos jetë formale dhe njëkohësisht të njohim edhe një lloj hierarkie. Në qoftë se krijohet një komision qendror, atëherë unë mendoj se ky komision duhet të ketë fuqi mbi komisionet vendore dhe komisionet të jenë ato që shërbejnë dhe ndihmojnë të interesuarit për mbledhjen e materialeve. Duke e votuar ligjin, duke e botuar në Fletoren Zyrtare dhe në mjete të tjera të komunikimit publik, ne mendojmë se të gjithë njerëzit e njohin dhe kanë mundësi ta kuptojnë atë, por jo të gjithë e kuptojnë gjuhën e një ligji, kështu që mendoj se këto komisione duhet të ishte mirë, sipas mendimit tim, të shërbenin për të ndihmuar dhe për të orientuar të gjithë të interesuarit se çfarë dokumentesh duhet të paraqesin ata, që do të thotë se nuk është e nevojshme të jenë vetëm dokumente me shkrim, por edhe dokumente të natyrës tjetër, të cilat provojnë qartësisht pjesëmarrjen në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare apo në akte të tjera shumë të rëndësishme, të cilat çojnë në njohjen me të drejtë të statusit. Nëse ne do të vendosim këtë lloj lidhjeje, unë besoj se ne do t'u shërbenim më shumë dëshmorëve.

Nga ana tjetër, ka disa momente që propozimet e Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve unë i gjej të formuluar pak më mirë. Domethënë, është e njëjta gjë që ka dashur të thotë edhe

Ministria e Mbrojtjes në projektin e vet, por që juridikisht më bën më shumë sens formulimi i organizatës. Për shembull, është propozuar që statusi i dëshmorëve t'u njihet të gjithë shtetasve shqiptarë, të cilët janë ekzekutuar apo kanë vdekur në kampet naziste të përqendrimit, apo kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende deri në datën 9 maj të vitit 1947. Po ta shohim propozimin e shkruar nga ministria dhe propozimin e organizatës dallohet qartësisht se është më korrekt propozimi që sjell organizata e dëshmorëve, sepse ne nuk mund të limitojmë kohën kur kanë qëndruar në kampe të përqendrimit. Dihet që 9 maji i vitit 1945 është dita botërore e fitores së popujve kundër nazifashizmit dhe parimisht edhe të gjitha kampet e përqendrimit u shpërbënë dhe kush ishte aty doli, por sidoqoftë ka njerëz që pasojat e qëndrimit në ato kampe i kanë vuajtur edhe dy vjet më pas dhe për këtë shkak kanë humbur jetën. Kështu që vendosja e këtij afati e mbyll këtë moment dhe dua që kolegët ta shohin që aty përcaktohet thjesht një afat maksimal, por nuk merret vesh kur fillon dhe kur mbaron, ndërkohë që organizata vendos një afat se deri në çfarë momenti njihet kjo lloj e drejte. Megjithatë, ky është një moment që do ta shohim edhe gjatë diskutimit nen për nen.

Unë mendoj se ne mund ta gjejmë gjuhën të gjithë së bashku dhe secili nga ne të japë kontributin e vet, me qëllim që të hartojmë një ligj të denjë, një ligj që edhe nëse bart një faturë financiare, që mendoj se ne nga këtu nuk e nxjerrim dot këtë faturë, por në vendimet e Këshillit të Ministrave që do të duhet të detajojnë angazhimet e këtij projekti, do të dalë edhe fatura financiare, të bëjnë kujdes që t'u japim atë nderim që u takon të gjithë të rënëve.

Faleminderit!

Para se të kalojmë në miratim në parim, dua t'u kaloj fjalën kolegëve për pyetje apo për diskutime.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea- Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Të nderuar kryetarë dhe përfaqësues të organizatave të dëshmorëve,

Në fakt, unë jam mbesë dëshmori, gjyshi im është mjeku i parë që është vrarë në Shkodër dhe sigurisht që jam shumë e ndjeshme ndaj këtyre problematikave, që lidhen me çështjet e Statusit të Dëshmorit të Atdheut, që në fakt janë figura të nderuara, për të cilët të gjithë ne ruajmë një respekt dhe patjetër duhet t'i kujtojmë dhe t'i mbështesim gjithmonë.

Në fakt, problematikat kanë qenë të ndryshme dhe ne si familje na ka shqetësuar fakti që koha kalon, fëmijët e dëshmorëve janë në mosha të thyera, të mos themi që disa nuk janë më dhe shoh që në përmirësimet që keni sjellë e keni zgjeruar mbështetjen për sa u përket personave, të cilët janë të lidhur me dëshmorët, ku keni futur edhe nipërit dhe mbesat e tyre. Kështu që mendoj se ky është një përmirësim. Për shembull, për vite me radhë prindërit e mi, dajat apo tezet nuk kanë përfituar nga ky status dhe kjo për arsye të disa shfuqizimeve që janë bërë dhe disa ngatërresave të sjella.

Sipas mendimit tim, futja në lojë e këshillave bashkiakë ka sjellë një anomali, moskoordinim të punës dhe në shumë raste edhe harresa. Kështu që, për sa kohë të gjitha janë të qarta dhe të gjithë bien dakord që ky është një status i nderuar, unë mendoj se sa më e thjeshtë të jetë struktura, aq më mirë është. Ky projekt duhet mbështetur, pasi edhe kostoja financiare, duke e krahasuar edhe me statusin e të persekutuarve, me të cilët nuk kam asgjë, nuk është aq e madhe.

Jam totalisht në mbështetje të këtij statusi, ashtu sikurse e vlerësoj faktin që ky komision qendror krijohet pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe mendoj se është shumë mirë që ky është organi që do të vendos për njohjen ose jo të statusit.

Ashtu sikurse e thashë, komisionet e ngritura pranë këshillave të qarqeve dhe prefekturave kam dyshimin se do të sjellin historinë e deritanishme, kështu që përsëri do të futemi në historinë e deritanishme që, për fat të keq, ka pasur një influencim politik dhe mendoj se nuk duhet të ketë. Partitë e majta apo të djathta duhet të bien dakord për statusin e dëshmorëve, i cili nuk ka qenë rasti për sa i përket situatës ku jemi ne sot. Kështu që shpresoj të mos ketë vështirësi të tjera. Pa dyshim e mbështes dhe mendoj se është një përmirësim i statusit aktual të dëshmorit.

Kam një pyetje për sa i përket nenit 22, ku thuhet: “Para nenit 25 do të shtohet institucioni shtetëror i dëshmorëve për evidentimin, regjistrimin e të dhënave dhe probleme të tjera që lidhen me dëshmorët e të gjitha kohërave”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se mundemi na jepni pak më shumë detaje në lidhje me këtë institucion nga se varet, si do ta kryejë aktivitetin, si do t’i mbledhë të dhënat e kështu me radhë. Ndoshta ju e keni thënë, kërkoj ndjesë në qoftë se është thënë në prezantimin tuaj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Urdhëroni, zoti Vukaj!

Shaqir Vukaj – Ashtu siç e thashë, kemi probleme pafund, kudo që të prekësh gjen probleme, sepse realisht nuk kemi një institucion shtetëror që të merret me problemet e dëshmorëve, ashtu siç e kanë vendet e tjera. Shumica dërmuese e vendeve, ua them këtë, sepse kam punuar shumë vite në Çekosllovakia, edhe çekët që kanë shumë pak dëshmorë, kanë institut të veçantë shtetëror, që merret me problemin e tyre, pa folur për italianët, pa folur për francezët, që të gjithë kanë një institut shtetëror. Për shembull, në luftën gjatë rrethimit të Shkodrës janë vrarë qindra e qindra vetë, por, fatkeqësisht vetëm 16 veta kemi të shpallur dëshmorë, të cilët u shpallën para një viti në saj të punës të jashtëzakonshme që ka bërë një person. Në kryengritjen e Malësisë së Madhe, në 1912, kam arritur i vetëm të gjej deri tani 103 të vrarë, që nuk janë shpallur dëshmorë, sepse nuk merret njeri me këtë punë. Unë mund të vazhdoj me shumë shembuj, por duhet të ketë një institucion, me historianë, specialistë e të tjerë që të merren me këto probleme, sepse kanë ngelur në rrugë. Pra, në rrethimin e Shkodrës kemi të vrarë që nga Librazhdi, nga Kavaja, nga Puka, nga Mirdita dhe nga Tropoja, por nuk kemi asnjë dëshmor të shpallur. Pra, janë qindra të vrarë. Pse? Sepse nuk është marrë kush me këto punë. Kjo është punë e historianëve dhe e studiuesve, pra i një institucioni të mirëfilltë shtetëror, siç e kanë shumica e vendeve të tjera demokratike. Kemi Institutin e të Përndjekurve, që subvencionohet nga shteti, kurse për dëshmorët nuk kemi asgjë shtetërore. Ne jemi të tre që folëm familje dëshmorësh, si zonja që foli, sepse unë jam nga Shkodra dhe e di mirë historinë. Ne merremi thjesht si amatorë, thjesht si të jashtëm, si një shoqatë shoqërore, jo shtetërore, por me këto probleme duhet të merret shteti. Mund të merret përvoja e vendeve të tjera bashkë me përvojën tonë dhe të punohet siç duhet në këtë drejtim. Prandaj ne kërkojmë me insistim që të krijohet një institucion i tillë shtetëror, jo kështu.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Jam dakord, vetëm thjesht mendoj se duhet një informacion se çfarë buxheti do të ketë kjo.

Shaqir Vukaj – Pranë Ministrisë së Mbrojtjes kemi një komision me 6-7 veta që punon dhe nuk ka nevoja për shtesë të madhe organike, sepse kemi një grupim njerëzish, pavarësisht se sa të aftë janë. Këtu duhen njerëz të angazhuar seriozisht, specialistë, historianë, pra njerëz të pasionuar.

Elona Gjebrea – Në fakt, ky është një shembull, pra ne duhet të marrim të gjithë leksione se si kur ke një vullnet të mirë gjërat realizohen edhe pa buxhete. Kjo vlen për t'u përsëritur dhe patjetër që do ta mbështes.

Mendoj se Ministria e Mbrojtjes duhet ta gjejë një hapësirë buxhetore për të mbështetur gjërat e vogla, por këto janë çështje që patjetër zëvendësministri do të....

Shaqir Vukaj – Ky është problemi i qeverisë. Një institucion të tillë e krijon qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç e kanë vendet e tjera.

Ermonela Felaj – Besoj se është e qartë.

Elona Gjebrea - Nuk e di nëse doli qartë, sepse kam merak, pjesa e këshillave bashkiakë. Në qoftë se ne do t'u lëmë kompetenca këshillave bashkiakë për të vendosur për gjëra të ndryshme, që kanë të bëjnë me statusin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e theksoj dhe e sjell me një shembull konkret, dikur spitali i Shkodrës ka pasur emrin e gjyshit tim, Jorgji Karamitri. Për arsye të çuditshme, të lidhura me deviacione partiake, ky emër nuk përmendet më, ndërkohë thuhet se janë spitale rajonale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këshilli bashkiak ka marrë një vendim, i cili qëndron në fuqi dhe hajde t'i ribësh edhe një herë ato vendime nga e para. Pastaj kjo do të sjellë edhe një anomali, sepse për të njëjtat gjëra nuk trajtohen dëshmorët njësoj. Ju mbështes totalisht.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka zonja Ekonomi.

Më pas fjalën e ka zoti Koçi.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të bëj një ndërhyrje të shkurtër, pasi disa nga problemet u trajtuan, por ajo që dua të them është se ne e pritëm me përkushtim ligjin, të gjithë u angazhuam për të lexuar dhe për të parë se çfarë gjërash duhet të thoshim te ky ligj, sepse ka diçka që kemi kuptuar: në harkun kohor të 18 vjetëve organizatat dhe ministria vetë kanë pasur probleme. Pra, keni hasur probleme në zbatimin e tij.

Ligji i vjetër kishte nevojë për një reformim shumë të madh nisur nga disa gjëra, që ishin parë në terren.

Së pari, duhet të zgjeroheshin kriteret.

Së dyti, kriteret duhet të kishin dëshmi të vërteta, sepse nuk mund të vazhdohej me dëshmi të rreme. Kjo do të bëhej për të nxitur pikërisht krenarinë e dikujt që ka një gjysh dëshmor, që ka një mik apo kushëri dëshmor, por që të ishte pjesë e krenarisë kombëtare, pra për ata që dhanë jetën për vendin. Ishte shumë e rëndësishme që këto të vihehin në një lloj rregulli.

Tjetër gjë e rëndësishme që ne e diskutuam, madje e dëgjuat edhe nga zonja Felaj, që është relatorja e ligjit, ishte si do të kishin rol këshillat bashkiakë. Ju keni sjellë një propozim për këshillat bashkiakë, sepse edhe ligji “Për procedurat administrative” kërkon një angazhim tjetër për këtë. Kështu që edhe këtë e kemi pasur në vëmendje.

Gjithashtu, na duhet një regjistër kombëtar për ata që janë dëshmorët e atdheut të vjetrit dhe të rinjtë. Ky regjistër kombëtar ka nevojë për disa karakteristika, që duhet të jenë unike, duhet të jenë për atë regjistër. Kjo kërkon një tjetër angazhim, pak më thellësisht të menduar. Por ne kuptojmë që pjesa më e rëndësishme e ligjit është që të ketë një lloj dinjiteti të vënë në vend për ata që dhanë jetën në mbrojtje të atdheut dhe që rritën vlerat e shqiptarisë kudo që ishin. Kjo pjesë është shumë e rëndësishme, sepse nuk lidhet me pjesën financiare, por lidhet me vendosjen pikërisht të kësaj krenarie kombëtare në vend. Kështu që, ne kur lexuam ligjin e pamë me shumë kujdes.

Ndërkohë, një nga diskutimet që ka ndodhur është mënyra se si do strukturohet vendosja e këtij regjistri, që besoj se do të na marrë kohën tonë të diskutimit. Këtë desha të shtoja, megjithëse një pjesë të madhe të gjërave e tha edhe zonja Gjebrea.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Faleminderit!

Po e nis nga kjo e fundit, lidhur me regjistrin kombëtar apo me institucionin që mund të merret në mënyrë më të organizuar me çështjet e statusit të dëshmorit të atdheut. Ne pranë Ministrisë kemi një staf teknik, i cili në zbatim të këtij ligji, me urdhër të ministrit, do të krijojë regjistrin kombëtar të dëshmorëve të atdheut. Tashmë janë bërë disa botime, ku në njëfarë mënyre është regjistri kombëtar të dëshmorëve të atdheut, megjithatë ai ka nevojë të plotësohet. Besoj se stafi teknik në zbatim të urdhrit të ministrit apo edhe të VKM-ve përkatëse, do të arrijë që ta realizojë këtë punë.

Për sa i përket shqetësimit të zotit Vukaj, i cili ka qenë edhe shqetësimi ynë, lidhur me demokratizimin e çështjes, me plotësimin dhe institucionalizimin e këtyre vlerave, që janë të pazëvendësueshme në historinë kombëtare, por edhe lokale, atëherë ne kemi bërë dy gjëra: së pari,

kemi vendosur që edhe këshillat bashkiakë të kenë fuqinë e propozimit, sepse prefekti, këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë dhe ministri kanë vetëm pushtet propozimi. Ata paraprakisht shqyrtojnë dokumentet, kërkesat e familjarëve apo të shoqatave që janë me karakter krahinor apo që janë shoqata që lidhen me dëshmorët, sipas fushave të caktuara, dhe më pas është komisioni qendror që vendos, pra nuk japin ato status. Pra, duke i dhënë një pushtet këshillit të bashkisë, mendoj se shumë nga ato shqetësime që tha zoti Vukaj, pra ka raste që në ngjarje të mëdha historike nuk janë përcaktuar mirë dëshmorët përkatës, martirët e asaj ngjarjeje, siç është rasti i rrethimit të Shkodrës, kjo e plotëson më së miri këtë gjë.

Së dyti, për sa i përket Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ligji i deritanishëm e kufizonte, sepse u jepte status dëshmor vetëm atyre që merrnin pjesë në luftë me armë në dorë. Ne po themi është edhe rasti i mbështetësve kur janë pushkatuar mbështetësit, apo edhe kur ka pasur pushkatime për hakmarrje. Pra, kanë shkuar në një fshat i kanë marrë njerëzit, sepse ata nuk janë vrarë aksidentalisht, janë vrarë qëllimisht nga armiku, edhe ata shpallen dëshmorë në shërbim edhe të një konteksti politik lidhur me numrin e dëshmorëve dhe me kontributin në viktima që ka dhënë Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku ka palë politike që mundohen ta kufizojnë. Përkundrazi, kjo është pjesë e krenarisë sonë kombëtare dhe është pjesë e kontributit ndërkombëtar të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, si një kontribut i cili është mirënjohur, ju e dini shumë mirë se në qoftë se nuk do të kishte ndodhur do të rrezikonte edhe integritetin territorial të Shqipërisë së sotme.

Kështu që, nga ana tjetër, ka edhe një risi, ligji i mëparshëm nuk përcaktonte fare se çfarë ndodhte me shtetasit shqiptarë, të cilat kanë dhënë jetën për interesat tona kombëtare, për çlirimin e Kosovës apo në luftëra të tjera, të cilët kanë lidhje me interesat kombëtare të shqiptarëve, por jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Tashmë këto përcaktohen mirë dhe shteti, komisioni qendror është i detyruar që t'i shpallë dëshmorë. Në qoftë se deri më sot ka pasur shpallje të individëve të caktuar, kjo më shumë është bërë nga fuqia morale e komisionit, por jo se është e detyruar të zbatojë ligjin. Tashmë ligji i detyron që t'i shpallë dëshmorë edhe këto raste.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka zonja Dhima.

Më pas të përgatitet zoti Vorpsi dhe zoti Harusha.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër, për prezantimin dhe paraqitjen e këtij drafti, që besoj se ka korrigjuar ligjin, i cili ka qenë në fuqi deri tani!

Falënderoj përfaqësuesit e organizatës së dëshmorëve për propozimet dhe sugjerimet në përmirësim të këtij projektligji!

Kam një pyetje për zotin zëvendësministër: a mendoni se stafi që ju keni aktualisht në Ministrinë e Mbrotjtjes do të luajë rolin e institucionit shtetëror të dëshmorëve, sipas propozimit që sjell organizata e dëshmorëve të atdheut? Stafi duhet të bëjë evidentimin, regjistrimin e të dhënave dhe probleme të tjera të dëshmorëve në të gjitha kohërat dhe zbatimin e këtij ligji. Pra, a mendoni se ai staf e kryen dhe nuk ka nevojë për shtesa strukture dhe efekte financiare?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Koçi!

Petro Koçi – Projektligji nuk ka asnjë efekt financiar.

Për sa u përket efekteve financiare, është në vijimësi të ligjit në fuqi. Domethënë, kjo është një gjë që duhet pasur parasysh në shqyrtimin dhe më pas në miratimin e këtij projektligji.

Më pas, për sa i përket institutit që propozohet, sigurisht është një ide interesante, mendoj se nuk mund ta kryejë punën stafi teknik. Për sa i përket regjistrimit, besoj se instituti do të kishte kompetenca studimore. Pra, janë punë që i kryejnë sot institutet e historisë, muzetë, arkivat, janë detyra që i kryejnë sot institucionet që janë të ngritura, por me ligje të tjera. Kështu që stafi teknik mund të kryejë detyrën e regjistrimit kombëtar, pra ai shqyrton rast pas rasti çdo propozim që vjen. Duhet thënë se shpesh propozimet e këshillave të qarqeve janë të pambështetura në kriteret ligjore, pra pothuajse çdo kërkesë që u shkon atyre përcillet në komisionin qendror, pavarësisht se nuk i plotëson kriteret. Jo çdo vdekje aksidentale dhe në krye të detyrës mund të jetë një rast për t'u shpallur dëshmor. Ideja është se dëshmor shpallet dikush, i cili vërtet ka humbur jetën, por në rrethanën kur ai, megjithëse e ka ditur rrezikun e humbjes së jetës, përsëri e ka kryer aktin. Ashtu siç ka ndodhur me dy marinarët që u vranë së fundi në një operacion kërkim-shpëtimi, që ishin në një angazhim privat, por gjithsesi dhanë jetën në kushtet kur jeta mund të rrezikohej dhe ashtu ndodhi. Pra, jo çdo ngjarje aksidentale është një arsye që moralisht ne t'i shpallim njerëzit dëshmorë. Propozimet që vijnë shpesh nga qarqet e komprometojnë këtë gjë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti zëvendësministër,

Të nderuar anëtarë të organizatës “Dëshmorëve të atdheut”,

Sigurisht, unë e vlerësoj këtë projektligj, ku së bashku me zotin Velo, për shkak të detyrës, kemi pasur kontakte të vazhdueshme dhe më vjen mirë që ky projektligj vjen sot, pas disa vjetësh përpjekje.

Në fakt, dua të ndalem te një eksperiencë që kam pasur për shkak të detyrës, sepse ndoshta një diskutim më të hollësishëm ne do ta bëjmë kur të kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Unë i kam parë propozimet e shoqatës, gjithashtu edhe projektligjin e ardhur nga Ministria e Mbrojtjes, dhe dua të ndalem konkretisht te neni 11 dhe neni 13. Në nenin 11 ju jeni shprehur për komisionet e prefekturave apo qarqeve. Sot ne nuk kemi komisione pranë prefekturave dhe ligji i vjetër nuk e saktëson. Për të hequr pjesën e këshillave bashkiakë, këtu e mbështes edhe kolegen time, zonjën Gjebrea, do të ishte mirë që të merrej parasysh propozimi i shoqatës apo organizatës së dëshmorëve për ta kaluar komisionin e këshillit të qarkut. Ky është niveli i dytë i qeverisë vendore dhe patjetër që përmbledh më tepër në rang qarku. Pra, nuk bëhet fjalë për një këshill bashkiak, por bëhet fjalë për rang qarku.

Lidhur me nenin 13, unë e pashë atë çka ju keni propozuar, por edhe atë që është propozuar në projektligjin e ardhur nga Ministrisë së Mbrojtjes, ku thuhet: “Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e “Dëshmorëve të atdheut” në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit”. Pra, kjo bëhet për eliminuar burokracitë institucionale, sepse vendimi i këshillit bashkiak kalon për verifikim ligjshmërie tek institucioni i prefektit dhe mendoj se vendimmarrja duhet t’i lihet institucionit të prefektit, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave. Pra, propozimi im është për të eliminuar burokracitë institucionale. Pra, të mbledhësh këshillin e qarkut për të lëvizur disa eshtra, që i ka vërtetuar komisioni apo një organ, që merret realisht me verifikimin e kriterëve dhe më pas të kalojnë në një vendimmarrjeje për verifikim ligjshmërie te prefekti, mendoj se si përfaqësues i Këshillit të Ministrave ky element burokratik t’i lihet si vendimmarrje vetëm institucionit të prefektit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Vorpsi!

Megjithatë, unë mendoj se është momenti më delikat, sepse kërkohet që të ruhet edhe etika, si dhe kërkohet të përfshihet edhe mjekësia ligjore. Kështu që do të lemë pak kohë për ta

menduar, qoftë ministria, qoftë ne, por edhe organizata e dëshmorëve. Sot unë mendova që të bëjmë vetëm diskutime në parim dhe që të marrim shkas nga këto diskutime për të kuptuar se çfarë fryme do t'i japim këtij projekti.

Po, zoti Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti zëvendësministër,

Të nderuar përfaqësues të organizatës “Dëshmorët e atdheut”.

Unë vë re këtu se propozimi është lënë në dorë të këshillave bashkiakë, këshillave të qarqeve apo të prefekturës. Me gjithë respektin që kam për këshillat e qarqeve, për këshillat bashkiakë, si dhe për prefektin, mendoj se propozimin për statusin e dëshmorit duhet ta bëjë organizata juaj dhe jo këshillat e qarqeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Këtë e kishit sugjerim.

Faleminderit!

Zoti Sinaj keni fjalën.

Më pas e ka fjalën zonja Gjebrea dhe do të kalojmë në votim.

Vullnet Sinaj – Ne do ta kalojmë edhe nen për nen, por kam një merak, që lidhet edhe me një rast në zonën time. Në nenin 8 thuhet: “Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” vlejnjë si burime parësore dokumente të organeve publike, të krijuara në kohën e ngjarjes dhe, si burime dytësore, botimet me karakter historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, të cilat shprehen për ngjarjen.” A duhen saktësuar të gjitha burimet parësore dhe dytësore për shpalljen dëshmor apo kur nuk ka parësore ka dytësore? Ne kemi raste kur nuk i kanë burimet parësore, por kanë dytësore. Pra, këtu duhet të shprehet më qartë ose parësoret, ose dytësoret.

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Pra, fjalia është “vlejnjë si burime parësore”. Në gjykimin e komisionit më e udhës do të ishte shprehja: “...kur ka burime parësore, në rast se jo vlejnjë edhe burimet dytësore”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Në qoftë se ka nevojë që ne ta theksojmë mund ta gjejmë fjalinë e duhur.

Besoj se nuk ka ndërhyrje të tjera nga kolegët ...

Paulin Sterkaj – Përshëndetje të gjithëve!

Më vjen keq që ne kemi ecur gjatë gjithë jetës sonë me ëndrrën se kemi 28 mijë dëshmorë dhe kemi qenë krenarë për këtë gjë, pasi ata 28 mijë dëshmorë kanë dhënë gjakun për atdheun. Këtu ne po flasim për pjesën e Luftës së Dytë Botërore. Sipas këtyre dokumentacioneve dhe me këto arshiva që kemi, na dalin 12 mijë dëshmorë në të gjitha kohërat. Prandaj, është një zhgënjim i madh për të gjithë administratën shtetërore në vite, që nga viti 1945 deri më sot.

Unë e mbështes këtë projektligj, jo vetëm për dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe ata të Rrethimit të Shkodrës, ku kanë dhënë jetën shumë individë dhe patriotë, të cilët nuk janë identifikuar, sepse historia kështu ka evoluar. Dua të bëj pak humor me kolegun, sepse ju nga Vlora dëshmorët i keni me shumicë, por neve na i kanë mohuar, sepse ata kanë dhënë jetën historikisht dhe nuk janë shkruar askund. Unë shfrytëzoj rastin që në këtë projektligj edhe ne të bëjmë lobimin tonë, në mënyrë që të identifikojmë njerëzit që kanë vlera historike. Unë mendoj se ka ardhur koha të vlerësojmë familjarët e afërm të dëshmorëve, të cilët mund të jenë shumë pak që jetojnë, që, përveç ndonjë përfitimi financiar, ma merr mendja se nuk kanë gjë më të madhe se sa të kenë një përfitim moral dhe të quhen familje dëshmori. Kjo të bëhet në mënyrë që të mos bëjmë si politikat e krahut tjetër, të cilët e kanë shkatërruar buxhetin e shtetit duke u dhënë para nipave e stërnipave të dëshmorëve. Unë çdo ditë marr telefonata nga të persekutuar, ku thonë se kanë edhe një këst për të marrë apo që nuk kanë marrë asnjë këst e tjerë. Ka ardhur koha që t'i japim vlerë morale cilitdo krah, cilitdo njeriu që ka dhënë jetën për vendin tonë, por jo, nuk duhet të ketë më kosto financiare, sepse duhet të mendojmë edhe për fëmijët tanë, që të mos paguajnë fatura të pavlefshme. Realisht në të gjitha vendet Perëndimore, Lindore apo ish-Lindore janë institute dhe gjithçka është në memorien e tyre, por te ne paska ndodhur një skandal i madh, sepse për 45 vjet nuk qenkan identifikuar dëshmorët dhe nuk ka asnjë arshivë, ku dosjet e Sigurimit të Shtetit janë të sistemuara aq mirë, përveçse ku ka futur duart politika, që mund të jetë grisur ndonjë emër. Pra, që Dëshmorët e Kombit nuk janë identifikuar kjo gjë mua, si deputet, po më zhgënjën.

Ermonela Felaj – Po, zoti Velaj ka një ndërhyrje.

Gjergj Velo – Në shtypin e përditshëm për të falsifikuar të vërtetën botohen shkrime nga profesorë dhe doktorë për të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore ose gjatë periudhave të ndryshme. Një shkrim i Teodor Karecos thotë se janë rreth 3 mijë dëshmorë dhe unë mendoj se këto shifra janë skandaloze. E vërteta është se organizata “Dëshmorët e atdheut” nuk ka asnjë lek për të bërë kurora për t'i vendosur në datën 5 Maj, sepse në këtë gjendje e ka lënë shteti. Ka libra voluminozë, të marrë nga çdo rreth me përgjegjësi, me emër dhe me mbiemër, që janë 28 mijë e 147 të rënë.

Ndërsa, jam plotësisht dakord me kritikën dinjitoze që bëri deputeti, të cilin e kam mik, por më vjen mirë që si mik u soll edhe këtu dhe u shpreh se kemi pasur 3 mijë apo 4 mijë dëshmorë të shpallur. Këto janë punët e qeverive, por këto qeveri nuk duhet të ecin në rrugën e atyre qeverive që nuk i kanë vlerësuar dëshmorët. Të paktën për moral duhet të themi se ai institut duhet të ketë shumë gjera që të vërtetojë statusin e dëshmorit, dhe jo vetëm për t'i evidentuar, sepse letrat janë gati, jo për të bërë një listë, por për të bërë shqyrtime serioze, për t'u marrë me veprat, me relikat, me varrezat, me memorialët e tyre e të tjerë.

Ne flasim sot për një Shqipëri turistike, por ne dallohemi edhe për trimëri, ndaj pse të mos e zhvillojmë edhe këtë anë të krenarisë sonë kombëtare. Këngët më të bukura ne i kemi për trimërinë, jo për dashurinë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Nuk dua të përsëris ato çfarë u shprehën kolegët këtu, por dua të theksoj edhe një herë faktin që këtu na është paraqitur një propozim krijimi i dy strukturave, qoftë të Komisionit Qendror apo Institutit Shtetëror të Dëshmorëve. Unë mendoj se këto struktura i kanë mundësitë dhe kapacitetet që të përballojnë më shumë punë, duke ua hequr këshillave bashkiakë. Involvimi për propozime nga këshillat e qarqeve, prefekturave e të tjerë do të sjellë vonesa dhe mendoj se kjo nuk është në të mirën tonë. Shumica e familjarëve të partizanëve apo të dëshmorëve janë në moshë shumë të thyer, kështu që mendoj se kjo vonesë nuk janë në favor të tyre.

Së fundi, mendoj se në përcaktimin për sa i përket Institutit Shtetëror të Dëshmorëve, duhet theksuar se nga cili institucion do të jetë i varur dhe ku do të jetë pozicionuar. Ne nuk mund të themi vetëm që të ngrihet institucioni shtetëror, pa e përcaktuar se çfarë do të kryejë ky institucion, ku do të jetë i atashuar, qoftë edhe pa efekte financiare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolege!

Petro Koçi – Kam një paqartësi.

Ermonela Felaj – Të gjithë doni të flisni, por kjo nuk është mbledhja e fundit, është thjesht e para.

Petro Koçi – Në projektligj nuk ka ndonjë propozim për ndonjë institut, këto janë propozime shtesë.

Ermonela Felaj – Po, janë të organizatës së dëshmorëve.

Petro Koçi – Ju do të bazoheni te projektligji pastaj do të shtoni më tej.

Së dyti, fuqia propozuese e këshillit të bashkisë e përshpejton punën, nuk e pengon, sepse nuk do të kalojë nga bashkia, te qarku dhe te prefekti...

Ermonela Felaj – Secila nga ato vjen direkt në komision.

Petro Koçi – Ne i kemi zgjeruar kriteret dhe do të ketë shumë punë, prandaj kemi thënë që me këtë propozim të merret edhe këshilli i bashkisë. Për shembull, ju e dini që të 101 të vrarët e Borovës nuk janë dëshmorë, ata quheshin viktima, por me ligjin e ri shpallen dëshmorë.

Ermonela Felaj – Në fakt, këtë shembull unë e mendova sapo ju shpjeguat që statusin e dëshmorit ia kemi dhënë jo thjesht atyre që janë vrarë me armë në dorë, por edhe të tjerëve, që janë vrarë për t'u hakmarrë për ngjarjet e ndodhura. Në fakt, Borova është një shembull i kësaj gjëje, sepse dihet që u dogj një fshat i tërë nga nazistët për këtë pjesë.

Megjithatë, dua t'i them zotit Koçi dhe përfaqësuesve e organizatës së dëshmorëve që ne kemi shtruar për diskutim të gjitha pikëpamjet tona dhe qartësisht kuptohet se në parim të gjithë jemi pro projektit. Ndërkohë, kjo nuk është mbledhja e fundit, sepse komisioni ynë është komision përgjegjës për këtë projekt, kurse komisioni për dhënie mendimi do të jetë Komisioni i Ligjeve. Pra, do të jetë dy komisione parlamentare që do të merren me këtë projekt. Unë dua t'u bëj me dije përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të organizatës së dëshmorëve, edhe mbi bazën e gjërave që ne diskutuam deri tani, që do të jenë në kontakt nga ana e komisionit për të parë të gjitha pikat mbi të cilat ne mund të biem dakord. Pra, të gjitha propozimet që vijnë nga organizata e dëshmorëve, nëse ne do të kemi mundësi, do t'i bëjmë pjesë të projektit, por ndërkohë do të mendojmë edhe 2-3 diskutime të tjera, që u hapën në këtë komision. Meqenëse ligji më shumë është i natyrës deklarative, sepse, siç e thamë, nuk ka faturë financiare për momentin, a mundemi ne, nëpërmjet këtij ligji, t'u njohim disa privilegje të mbrojtjes sociale familjarëve të afërt të dëshmorëve, për shembull, bashkëshortëve që kanë mbetur vetëm?

Së dyti, a mund ta deklarojmë në ligj dhe t'ia ngarkojmë si detyrim vetes, që në një të ardhme të afërt, që të mund të konceptojmë pse jo edhe një institut që të merret me ato që u thanë? Pra, ne ende nuk kemi vendosur për të gjitha këto propozime, por për sa kohë nuk i kemi të shkruara se deri ku do të shkojnë të tilla propozime, natyrisht nuk mund të themi po ose jo. Mendoj se këtë kohë ne duhet ta shfrytëzojmë për të reflektuar dhe për të parë edhe modele të vendeve të tjera, me qëllim që ta plotësojmë ligjin dhe të bëjmë vërtet një ligj siç duhet, duke qenë gjithmonë objektiv, sepse kjo është shumë e rëndësishme. Pra, është e rëndësishme që këtë moment, pavarësisht

ndjeshmërisë që kemi ndaj luftës dhe ndaj të rënëve në përgjithësi, ne ta përdorim në mënyrën sa më objektive të mundur, që respektin ta marrë ai që vërtet e meriton.

Atëherë, ju lutem kolegë, kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për statusin e “Dëshmorit të atdheut”?

Dakord!

Miratohet.

Të gjithë kolegët ranë dakord dhe më vjen mirë që nuk ka kundërshtime dhe abstenime.

Për mbledhjen e ardhshme do të njoftoheni.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA